

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4597/1 datë 08.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4644/8 datë 18.11.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024, miratoi sa vijon:

Aktvendim

për paralajmërimin publik dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimeve programore

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHPK eksport-import Shkup, për shkak se ka ritransmetuar shërbime programore që nuk janë të regjistruara në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-4597/1 datë 08.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHPK eksport-import Shkup, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, pra të përjashtojë ritransmetimin e shërbimeve programore.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimeve programore.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes nga pika 1 i këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, pra vazhdon të kryejë shkeljen për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia, në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose të rregulloreve të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetet publike të komunikimit elektronik nga aspekti i pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV Agjencia, me datë 05.11.2024, Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të paketës programore të ritransmetuar nga operatori Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHPK eksport-import Shkup, nga ku është konstatuar se operatori në fjalë që sipas notifikacionit nga Agjencia për komunikime elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 05.11.2024, për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore që nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në

kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë detajisht të specifikuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4597/1 datë 08.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës ark.nr.11-4597/1 datë 08.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4644/8 datë 18.11.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim ku ndaj subjektit të mësipërm të ndërmirret masë vërejtje publike dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që të përjashton ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhrit, gjegjësisht sipas paralajmërimit publik dhe ka ndërprerë ritransmetimin e shërbimeve programore .

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.11-4597/1 datë 08.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.